



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 352 Prot.

Tiranë, më datë 18 .09 .2019

VENDIM

Nr.289, datë 18.09.2019

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTIT

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, pas shqyrtimit më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 18.09.2019,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Rehabilitimi i territorit të ish-Gurores në parkim, Dhërmi”, “Rehabilitimi i hapësirës publike “Kthesa Potam” (U-TURN), Dhërmi”, “Rikonstrukcion i kalldrëmeve në Dhërmi”, “Restaurim i disa skedave në Dhërmi dhe Vuno”, në kuadër të projektit “Rikualifikim urban dhe restaurim i objekteve në Qendrat Historike të fshatrave Dhërmi dhe Vuno dhe Zonës së Mbrojtur përreth tyre”, me kërkesë të shoqërisë “SON Engineering & Construction” sh.p.k;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1;
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elva MARGARITI

SEKRETAR I KKR

Arta Dollani

